

H Y R J E

Ky Buletin përfshinë aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në mandatin e parë të zgjedhjeve pas luftës të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Buletini përmbanë aktivitetin që ka zhvilluar Kuvendi i Komunës gjatë kohës së mandatit të vet prej zgjedhjeve vendore të datës 28.10.2000 e deri në zgjedhjet vijuese të caktuara për datën 26.10.2002.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për punë profesionale të Kuvendit të Komunës.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës në periudhën e parë mandatore, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jet sa më transparentë aktiviteti i zhvilluar.

Meqë është fjala për një buletin që përpilohet për herë të parë pas luftës, Shërbimi për punë profesionale të Kuvendit është mirënjohës për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat do të ipen lidhur me te. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhshme të jetë më i suksesshëm dhe më cilësor.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Sipas Rregullores së UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45 të datës 11 gusht 2000 e në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, formohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal si hap drejt bartjes progresive të përgjegjësisve administrative të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Sipas po të njejtës rregullore Kuvendi Komunal është organi më i lartë përfaqësues i Komunës i cili zgjidhet në mënyrë direkte.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë në zgjedhjet e para të pasluftës të mbajtura më 28.10.2000 numron 31 anëtar.

Përbërja e Kuvendit të Komunës pasqyron përfshirjen e spektrit politik që ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave.

Kuvendi i Komunës ka këtë përbërje të spektrit politik:

Nga Dega e PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës):

Tahir Çaka,	9. Hajrush Dullovi,
Xhabir Zharku,	10. Rushan Ceka,
Xhelal Gashi,	11. Musli Luma,
Heset Loku,	12. Sali Selmani,
Ibush Vishi,	13. Faik Guri,
Njazi Ilazi,	14. Qerim Shahini,
Muhamet Malsiu,	15. Muharrem Baftiu dhe
Muharrem Ahmetaj,	16. Beqir Krasniqi.

Nga Dega e LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës):

1. Hebib Shehu,	3. Lutfi Zharku,
2. Sali Bajra,	4. Muzafer Luma,
5. Shiqeri Luzha,	9. Sali Bruti,
6. Fehmi Krasniqi,	10. Shefket Guri,
7. Muharrem Dashi,	11. Milaim Berisha dhe
8. Zahir Doda,	12. Sahit Bela.

Nga Dega e AAK-së (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):

1. Naser Kuka dhe 2. Kemal Teneqja.

Nga Dega e PRK-së (Partia Republikane e Kosovës):

Deli Krivanjeva.

Përbërja e këtillë e Kuvendit të Komunës pëson ndryshime me atë që në vend të Heset Lokut, për shkak të dorëheqjes si pasojë e mospërputhshmërisë së funksionit, caktohet Selman Luzha, ndërkaq Naser Kuka jep dorëheqje kurse në vend të tij nuk caktohet anëtar tjetër. Kështu Kuvendi i Komunës vazhdon punën me 30 anëtar.

Përbërja e Kuvendit në spektrin e përbërjes politike pëson ndryshime me atë që anëtari Sali Bajra nga LDK kalon në AAK, ndërkaq Deli Krivanjeva nga PRK kalon në PDK.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Viti 2000

MBLEDHJA E I-rë

Mbledhja e parë (konstituive) e Kuvendit të Komunës mbahet më datë 23.11.2000. Mbledhjen e thret dhe me te udhëheq Administratori Komunal z. Bawol Cabiri.

Në këtë mbledhje shqyrtohen këto qështje:

Zgjedhja e Kryetarit të Komunës dhe
Zgjedhja e Zavendëskryetarit të Komunës.

Për Kryetar të Komunës zgjedhet z.Tahir Çaka.
Për Zavendëskryetar të Komunës zgjedhet z.Xhabir Zharku.

Pas dorëheqjes së Zavendëskryetarit të Komunës z. Xhabir Zharku në postin e Zavendëskryetarit të Komunës zgjedhet z. Xhelal Gashi.

MBLEDHJA E II-të

Mbledhja e dytë mbahet më datën 21.12.2000. Mbledhjen e kryeson dhe me te udhëheq Kryetari z. Tahir Çaka.

Në këtë mbledhje shqyrtohen këto qështje:

Caktohet numri i Drejtorive komunale;
Emrohet Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe
Emrohet Komiteti për Ndërmjetësim.

1. Drejtoritë komunale

Në nivel komunal formohen këto Drejtori komunale:

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa;
Drejtoria për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim;
Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
Drejtoria për Arsim;
Drejtoria për Urbanizëm dhe Punë Komunale-Banesore;
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit.

2. Komiteti për Politikë dhe Financa

Formohet Komiteti për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:
Tahir Çaka, për Kryetar (sipas funksionit që ka) nga PDK,

Muhamet Malsiu, për anëtar nga PDK,
Njazi Ilazi, për anëtar nga PDK,
Heset Loku, -“- -“- -“- ,
Ibush Vishi, -“- -“- -“- ,
Lutfi Zharku, -“- nga LDK,
Shefket Guri, -“- -“- ,
Zahir Doda, -“- -“- dhe
Naser Kuka, -“- nga AAK .

Kjo përbërje pëson ndryshime me atë që anëtarët Muhamet Malsiu, Heset Loku dhe Naser Kuka japin dorëheqje dhe në vend të tyre caktohen: Xhabir Zharku, Rushan Ceka dhe Kemal Teneqja.

K o m i t e t i p ë r N d ë r m j e t ë s i m

Formohet Komiteti për Ndërmjetësim në këtë përbërje:

Xhelal Gashi, për Kryetar nga PDK,
Faik Guri, për anëtar nga PDK,
Musli Luma, -“- -“- ,
Hebib Shehu, -“- nga LDK,
Sali Bruti, -“- -“- ,
Deli Krivanjeva, -“- nga PRK dhe
Kemal Teneqja, -“- nga AAK.

V i t i 2001

MBLEDHJA E III-të

Mbledhja e Tretë e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datën 17.01.2001. Mbledhjen e kryeson dhe me të udhëheq Kryetari z. Tahir Çaka.

Në këtë mbledhje shqyrtohen qështjet lidhur me:

Zgjedhjen e Komisionit për intervistim,
Përcaktimin e formës së diskutimit publik për aprovimin e
Propozim Statutit të Komunës, dhe

Qështje të ndryshme.

1. K o m i s i o n i p ë r i n t e r v i s t i m

Në këtë mbledhje është zgjedhur Komisioni për intervistim në këtë përbërje:

Tahir Çaka, për Kryetar,
Njazi Ilazi, për anëtar,
Xhelal Gashi, - “ - ,
Sali Bajra, - “ - dhe
Fehmi Krasniqi -“- .

MBLEDHJA E IV

Mbledhja e Katërt është mbajtur më 30.01.2001. Këtë mbledhje e kryeson dhe me te udhëheq z.Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje është debatuar për:

Zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv dhe
Eventuale.

Në këtë mbledhje për Kryeshef Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës zgjedhet z. Eshref Vishi.

MBLEDHJA E V-të

Mbledhja e Pestë është mbajtur më datën 06.02.2001. Këtë mbledhje e kryeson dhe me te udhëheq Kryetari z.Tahir Çaka.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës vendos për aprovimin e Statutit të Komunës dhe zgjedhjen e Drejtorve të Drejtorive komunale.

Për Drejtor të Drejtorive Komunale zgjidhen:

1. Hestet Loku, jurist i diplomuar, për Drejtor të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme,
2. Misim Sopa, sociolog, për Drejtor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Azem Guri, Profesor i kimisë, për Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
4. Qamil Stagova, Injnier i ndërtimtarisë, për Drejtor të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Punë Komunale-Banesore,
5. Fadil Curi, Gjuhëtar, për Drejtor të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
6. Xhelal Luma, Injnier i blegtorisë, për Drejtor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në këtë mbledhje nuk janë plotësuar postet për këto Drejtori:
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa,
Drejtoria për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim dhe

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

MBLEDHJA E VI-të

Mbledhja e gjashtë e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datën 20.03.2001. Mbledhjen e kryeson dhe me te udhëheqi Kryetari z. Tahir Çaka.

Në këtë mbledhje janë shqyrtuar këto qështje:

1. Është debatuar lidhur me situatën aktuale politike pas arritjes së të ikurve nga IRJ e Maqedonisë.

Lidhur me këtë qështje Kuvendi i Komunës formon një komision prej 7 antarëve për përpilimin e një deklarate si dhe formon Shtabin e emergjencës prej 12 antarëve;

2. Është miratua Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil të Komunës;

3. Është miratua Propozim Vendimi për organizimin e Shërbimit profesional për punë të Kuvendit;

Janë plotësuar Drejtoritë komunale edhe ate:

1. Fikri Vërbani, për Drejtor të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
2. Agim Vishi, për Drejtor të Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim dhe
3. Muzafer Çaka, për Drejtor të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi.

Po në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- bën plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në atë mënyrë që ne vend të Heset Lokut caktohet Rushan Ceka;

- njoftohet për zgjedhjen e Drejtorit të Ndërmarrjes komunale "Lypeteni",
- prezentohet kërkesa e Mehmet Bushit për projektin e qendrës sportive në shpatijet e Sharrit;

- prezentohet buxheti i Komunës për vitin 2001 si dhe

- njoftohet për gjendjen në Organizatën punuese "Silcapor".

MBLEDHJA E VII-të

Mbledhja e Shtatë e Kuvendit është mbajtur më datën 30.04.2002 nën kryesinë e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi:

Aprovon Rregulloren e Punës së Kuvendit;
Aprovon buxhetin e Komunës për vitin fiskal 2001;
Aprovon Vendimin për taksat komunale për vitin 2001;
Aprovon Rregulloren për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ujë sjellsit, kanalizimit dhe deponimit të mbeturinave së bashku me vendimin e çmimeve për shfrytëzimin e tarifave komunale;
Aprovohet vendimi për punimin e Emblemës së Komunës;
Shqyrtohet situata në Organizatën Punuese Ekonomia Pyjore
Shqyrtohet qështja e kompenzimit të antarëve të zgjedhur si dhe Kryetarit dhe Nënkyetarit të Komunës;
8. Shqyrtohen edhe qështje të ndryshme në interes të antarëve të Kuvendit.

MBLEDHJA E VIII-të

Mbledhja e Tetë është mbajtur më 04.05.2001 nën drejtimin e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Shqyrton kërkesën e NTP “Bushit” për dhënjen e lejes për realizimin e qendrës sportive “Kaçaniku”;
2. Merr vendimin për menagjimin e pyjeve nga Komuna;
3. Merr vendimin mbi ndryshimin e sistematizimit të vendeve të punës në Shërbimin profesional të Kuvendit si dhe
4. Merr vendimin për kompenzimin e puntorve të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”.

MBLEDHJA E datës 12.06.2001

Mbledhja e radhës është mbajtur më datën 12.06.2001 nën kryesinë e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr vendim për shpalljen e Sharrit zonë me interes shoqëror;
2. Aprovon Rregulloren mbi urbanizmin;
3. Merr vendimin për formimin Drejtorisë Civile dhe Emergjencë;

4. Merr vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronave të palujtshme kontestuese në territorin e Komunës së Kaçanikut Kooperativës Bujqësore në Shtërpcë;
5. Formohet Komisioni për zgjedhjen e Emblemës së Komunës;
6. Debatohet rreth Kornizës kushtetuese si dhe
7. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E IX-të

Mbledhja e Nëntë është mbajtur më 28.06.2001 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Shqyrton vlerësimin e shpejtë të zhvillimit strategjik për vitin 2002-2004;
2. Miraton vendimin për dhënjën në shfrytëzim të përkohshëm të lokacionit “Guri i Zi” NTP “Bushi” për Qendrën rekreative-sportive “Kaçaniku”;
3. Shqyrtohet Raporti i Shtabit Komunal të Emergjencës;
4. Vendos për përsëritjen e Konkursit për zgjedhjen e Emblemës të Komunës si dhe
5. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E X-të

Mbledhja e Dhjetë është mbajtur më 23.08.2001, nën udhëheqjen e z. Xhabir Zharku, Nënkryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

Njoftohet me materialin për fushatën zgjedhore;
Merr vendimin mbi organizimin e Shërbimit të ofiçarisë;
Merr vendimin për lirim nga taksat komunale;
Shqyrtohet propozim-vendimi për formimin e Komisionit për emërtimin e vendbanime si dhe
Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E XI-të

Mbledhja e Njëmbëdhjetë mbahet më datën 20.09.2001 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Aprovon Vendimin për formimin e Komisionit për emërtimin e vendbanimeve;
2. Aprovon vendimin për aplikimin e projektit të vitit 1989 për qendrën zejtare;
3. Aprovon Vendimin për zgjedhjen e Emblemës të Komunës;
4. Debatohet rreth reagimit në shkrimin për manifestimin e ditës së “ 7 Shtatorit”, si dhe
5. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E XII-të

Mbledhja e Dymbëdhjetë mbahet më datën 31.10.2001 nën udhëheqjen e z.Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- Aprovon Rregulloren mbi Inspektionin e tregut;
Aprovon Pilot projektin mbi pronat komunale;
Aprovon Vendimin për dhënjen në shfrytëzim TMK-së objektin dhe pronën përreth objektit;
4. Aprovon Vendimin për shpalljen e diskutimit publik për standardizimin e toponimeve si dhe
 5. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E XIII-të

Mbledhja e Trembëdhjetë është mbajtur më 19.12.2001 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Aprovon Raportin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve; ionit Komunal të Zgjedhjeve;
- Aprovon Informatën për realizimin e mjeteve buxhetore;
Aprovon Rregulloren mbi inspektimin higjieno-sanitar të artikujve ushqimor dhe të gjërave të përdorimit të përgjithshëm;
4. Aprovon Vendimin mbi ndrimin e pasurisë së palujtshme dhe bartjen e pasurisë pa kompenzim;
 5. Aprovohet Vendimi për ndarjen e bursave studentëve të Komunës, si dhe
 6. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E I-rë

Mbledhja e Parë e Kuvendit të Komunës në vitin 2002 është mbajtur më datën 07.02.2002 nën kryesinë e z.Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje janë shqyrtuar këto çështje:

1. Është vendosur që të përtritet Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Ndërmjësime edhe në këtë periudhë njëvjeçare me të njëjtit kandidat të zgjedhur më parë;
2. Është marrë vendimi për formimin e Komitetit për vendbanime dhe lagje urbane;
3. Është aprovuar Rregullorja mbi procedurat e përgjithshme në SHCK;
4. Aprovohet Rregullorja mbi procedurat e menagjimit financiar në SHCK si dhe
5. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E II-të

Mbledhja e Dytë është mbajtur më 15.02.2002 nën kryesinë e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës ka debatuar sipas këtij Rendi të punës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit hapsinor e urban për Qendrën rekreativo-sportive dhe turistike “Kaçaniku”;
2. Informatë rreth buxhetit të Komunës për vitin fiskal 2002 dhe
3. Të ndryshme.

MBLEDHJA E III-Të

Mbledhja e Tretë është mbajtur më 27.03.2002 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Merr vendim për miratimin e dorëheqjes së Naser Kukës nga antari i Kuvendit të Komunës;
2. Merr vendim me të cilin aprovohet dorëheqja e Xhabir Zharkut nga posti i Nënkrjetarit të Komunës;
3. Merr vendim për shkarkimin e Naser Kukës nga antarësia në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në vend të tij cakton z. Kemajl Teneqja;

4. Merr vendim për aprovimin e Raportit për realizimin e mjeteve buxhetore për vitin fiskal 2001;
5. Shqyrton projekt buxhetin për vitin fiskal 2002;
6. Merr vendim për participim me mjete financiare nga buxheti i Komunës për ndërtimin e rrugës në Ivajë si dhe
7. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E IV-të

Mbledhja e Katërt është mbajtur më 28.03.2002 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi:

1. E plotëson Komitetin për Politikë dhe Financa kështuqë nga Komiteti për Politikë dhe Financa shkarkohet Muhamet Malsiu dhe në vend të tij caktohet Xhabir Zharku;
2. Aprovon Raportin e punës të Bordit të Drejtorëve për vitin 2001;
3. Aprovon Buxhetin e Komunës për vitin fiskal 2002;
4. Aprovon Programin e punës të Bordit të Drejtorëve për vitin 2002;
5. Aprovon Raportin e punës të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2001;
6. Aprovon Raportin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2001;
7. Aprovon Planin e vëllimit fizik të Ekonomisë Pyjore në Kaçanik për vitin 2002;
8. Aprovon Informatën për mbjelljet pranverore në territorin e Komunës për vitin 2002 si dhe
9. Çështje të ndryshme.

MBLEDHJA E V-të (e jashtzakonshme)

Mbledhja e Pestë e jashtzakonshme mbahet më 10.04.2002 nën drejtimin e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Debaton rreth qështjes së cenimit të kufirit;
2. Vendos për caktimin e deponisë në f. Stagovë;
3. Vendos për standardizimin e emrave të vendbanimeve të Komunës së Kaçanikut si dhe
4. Qështje të ndryshme.

Në këtë mbledhje Kryetari i njofton anëtarët e Kuvendit me vendimin e grupit të LDK-së për tërheqjen e antarëve të vet nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

MBLEDHJA E VI-të

Mbledhja e Gjashtë e Kuvendit të Komunës është mbajtur më 24.04.2002 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- Komunës;
1. Merr Vendim për zgjedhjen e z. Xhelal Gashi për Nënkryetar të Komunës;
 2. Debaton rreth cenimit të kufirit;
 3. Aprovon Rregulloren mbi eksploatimin e burimeve minerale;
 4. Aprovon Rregulloren mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe specifikimin e personelit të Zyrës për gadishmëri emergjente dhe mbrojtje civile;
 5. Merr vendim për ndrrimin e palujtshmërive si dhe
 6. Qështje të ndryshme.

MBLEDHJA E VII-të (e jashtëzakonshme)

Mbledhja e Shtatë (e dytë e jashtëzakonshme) mbahet më datën 15.05.2002 nën kryesinë e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Këtë mbledhje Kuvendi i Komunës ia kushton debatimit rreth cenimit të kufirit. Në këtë mbledhje formon Komisionin për hartimin e deklaratës dhe formon Këshillin e protestave.

MBLEDHJA E VIII-të

Mbledhja e Tetë është mbajtur më 08.07.2002 nën drejtimin e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

- Komunës;
1. Merr vendim që të fillohet procedura e ndryshimit të Statutit të Komunës;
 2. Merr vendimin me të cilin rrefuzohet propozim-vendimi për ndërtimin e lokaleve afariste në afërsi të shkollës së mesme “Skenderbeu”;
 3. Merr vendimin për aplikimin e taksave dhe ngarkesave të Drejtorisë për Urbanizëm;
 4. Merr vendim për formimin e Komisionit për mikrotoponimet;
 5. Shqyrton Raportin e Komisionit komunal të zgjedhjeve;
 6. Merr vendim për ndrrimin e pasurisë së palujtshme si dhe
 7. Qështje të ndryshme.

Në këtë mbledhje Kryetari përshëndet grupin e nxënësve musafir nga qyteti Moosseedorf (Zvicër) të cilët prezentojnë në mbledhjen e Kuvendit.

MBLEDHJA E IX-të

Mbledhja e Nëntë mbahet më datën 06.08.2002 nën udhëheqjen e z. Tahir Çaka, Kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës:

1. Aprovon Rregulloren për implementimin e Tatimit në pronë në Komunën e Kaçanikut;
2. Aprovon Raportin për realizimin e mjeteve buxhetore të Komunës për periudhën Janar-Qershor 2002;
3. Aprovon Buxhetin e Zyrës për taksë në pronësi për vitin fiskal 2002;
4. Merr vendim me të cilin aprovon skemën e Komitetit për menaxhimin e krizave në Komunën e Kaçanikut;
5. Njoftohet me Planin operativ për fushatën e korrje-shirjes;
6. Aprovon vendimin për plotësimin e Rregullores për pagesën e tarifave që përfshinë ngarkesat e Drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe mbrojtje të mjedisit;
7. Merr vendim për ndarjen e trollit për ngritjen e shtatores së Dëshmorit të Kombit Komandantit të UÇK-së Agim Bajrami në Kaçanik;
8. Merr vendim për ndarjen e trollit për ngritjen e lapidarit për viktimat civile të luftës në Kaçanik si dhe
9. Qështje të ndryshme.

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2001 i mban edhe dy mbledhje me karakter solemn edhe ate:

Më datën 11.06.2001 Kuvendi i Komunës ia kushton një mbledhje solemne 11 Qershorit ditës së çlirimit dhe më 04.07.2001 poashtu Kuvendi i Komunës mban një mbledhje solemne në shenjë të përcjelljes së Administratorit Komunal Bawol Cabiri dhe pritjes së Administratorit të ri Zia Mohammad.

Zgjedhjet e dyta lokale janë caktuar për datën 26.10.2002.

Fushata parazgjedhore ka filluar prej datës 10.09.2002.

Në shenjë përkrahje popullit amerikan për sulmin terrorist të 11 shtatorit 2001– fushata parazgjedhore shtyhet për dy ditë.

NGA SHËRBIMI I KUVENDIT